


PLANI I MENAXHIMIT I BASENIT UJOR ISHËM

Shtojca Teknike IV (Presionet)

1 METODOLOGJIA E IDENTIFIKIMIT TË PRESIONEVE DHE NDIKIMEVE NË BASENIN E LUMIT ISHËM

Direktiva Kuadër e Ujit e Bashkimit Evropian (DKU) rekomandon analizat e presionit dhe ndikimit si një metodë e vlerësimit të rrezikut për arritjen e objektivave të cilësisë ekologjike. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë presionet dhe ndikimet në basenin e lumit Ishëm duke marrë parasysh presionet e ndryshme antropogjene. Për të identifikuar forcat lëvizëse dhe presionet dhe ndikimet kryesore në basenin e lumit Ishëm, është ndjekur skema kuadër NPGjIP, si më poshtë:

Figura 1-Skema e kornizës NPGjIP



1.1 NXITËSIT

Si shumë lumenj në Shqipëri, burimi kryesor i ndotjes së basenit të lumit Ishëm janë shkarkimet urbane. Lumi Ishëm përfaqëson një zonë ujëmbledhëse sipërfaqësore shumë të ndotur. Shkarkimet urbane përmbajnë lëndë organike, baktere dhe viruse patogjene; komponimet e tretshme të fosforit dhe azotit, që favorizojnë procesin e eutrofikimit, dhe metale të rënda me shumë rreziqe në ndotje. Është i pranishëm bashkimi dhe përzierja e ujërave sipërfaqësore shumë të ndotura të lumenjve të Tiranës, Lanës dhe Tërkuçës. Lumi ka prurje të konsiderueshme, me ngjyrë të errët, shpesh herë të turbullt, në sipërfaqen e të cilit shpesh notojnë mbetje të plastikës së ndryshme dhe përgjatë lumit ka një erë të pakëndshme, e cila është mjaft shqetësuese për banorët që jetojnë buzë lumit.

Krahas burimeve të njohura të ndotjes industriale, aktualisht, në brigjet e lumit Lana janë vendosur familje, duke e kthyer këtë zonë në një zonë urbane (Murgu H., Muça F., Hysa R. Raporti hidrologjik: Rimëkëmbja urbane e bllokut ndërmjet Bulevardit Blu dhe rrugës “OSBE”, Bashkia Kamëz). Ndërtimi i këtyre shtëpive është bërë pa asnjë studim paraprak dhe pa kritere të përcaktuara. Pjesa më e madhe e banesave që janë ndërtuar buzë lumit, që shpesh përmythen nga prurjet e lumit Lana, të cilat në shumë raste janë në sasi të mëdha.

Banorët në shumë raste i kanë mbushur zonat me dhe, për ta kthyer në tokë të përshtatshme për ndërtim apo në territore banimi ose biznesesh që banorët kanë. Këto mbushje masive kanë çuar në shumë raste në devijime të rrjedhës së lumit. Zonat kryesore të banimit janë Lagja Ali Demi, Kodra e Priftit dhe Shkoza, ndërsa ka zona të tjera periferike të zhvilluara dhe të populluara pas viteve '90.

Figura 2- Zonat urbane përgjatë lumit Lana




Tabela 1- Përmbledhje e forcave nxitëse

Burimi i shpërndarë	Sistemi i kullimit urban (përfshirë rrjedhjen e ujit) Aktivitetet industriale Bujqësia e shpërndarë (pesticidet, mbetjet e plehrave) Pylltaria Të tjera
Burime pikësore	Uji i ndotur Toka të ndotura Bujqësia pikësore Menaxhimi i mbeturinave (mbeturinat e ngurta që hidhen në basenin e lumit) Akuakultura
Aktivitetet që përdorin substancat specifike	Fabrikimi, përdorimet dhe emetimet nga të gjithë sektorët industrial/bujqësor
Morfologjike	rregullimi i rrjedhës menaxhimi i lumit

1.2 PRESIONET

1.2.1 Burimet antropogjene të ndotjes

Ndotja kimike antropogjene shkaktohet nga aktiviteti urban. Industria minerale dhe kimikatet e saj janë dy burimet më të rëndësishme të ndotjes kimike, megjithëse industri të tjera si ato të pesticideve, elektrike, fabrikimit dhe përpunimit të lëkurës, letrës dhe mbetjeve urbane sigurisht që kanë ndikim në këtë basen ujor.

Secila prej këtyre industrive ka nënkategoritë dhe karakteristikat e veta (Çullaj A., 2005), siç janë renditur më poshtë:

1. Burimet industriale të ndotjes së ujit;
2. Burimet bashkiake të ndotjes;
3. Burimet bujqësore të ndotjes;
4. Burimet e rrjedhjeve të reshjeve;
5. Burimet nga venddepozitimet e ngurta;

Në përgjithësi dallohen tre lloje të ndotjes: ndotja fizike, kimike dhe ndotja biologjike (FISH 1992).

1.2.2 Ndotës kimik

Ndotësit e ujit klasifikohen në: ndotës kimikë, substanca që e varfërojnë oksigjenin e tretur, lëndët ushqyese, lëndët e ngurta të pezulluara dhe ndotësit mikrobiologjikë. Ndotësit kimikë të ujit ndahen në ndotës organikë dhe inorganik.

Ndotësit organikë ujqorë përfshijnë: insekticide dhe herbicide, shumë kripëra organike, mbetje ushqimore, fragmente pemësh dhe shkurresh, hidrokarbure të naftës, të cilat përfshijnë lëndë djegëse (benzinë, naftë, qymyr dhe lëndë djegëse vajore) dhe lubrifikantë (vajra motori), detergjentë dhe produkte kozmetike.

Ndotësit inorganik përfshijnë: metalet e rënda, mbetjet kimike industriale, plehrat, nitratet dhe fosfatet.

1.2.3 Ndotja nga shkarkimet e ngurta dhe të lëngëta industriale dhe urbane

- *Ndotja nga venddepozitimet e parregulluara të mbetjeve të ngurta*

Mbetjet e ngurta urbane hidhen fatkeqësisht në ujërat e lumit Ishëm dhe brigjeve të tij, si dhe në lumenj të tjerë të Shqipërisë. Mbetjet e ngurta nga zonat urbane derdhen përgjatë lumit. Një pjesë e tyre digjet dhe një pjesë tjetër bie direkt në ujin e lumit ose qëndron në breg dhe depozitohet më ngadalë në ujë, pas reshjeve. Shtrati i lumit Ishëm është kthyer në një vendgrumbullim të madh mbetjesh urbane që vijnë nga bashkia e Tiranës. Gjithashtu përgjatë rrjedhës së lumit Ishëm vërehen edhe mbetje ndërtimore të hedhura nga subjekte dhe individë të papërgjegjshëm.

Uji i lumit Ishëm, që derdhet drejt e në detin Adriatik, transporton ndotjen dhe mbetjet përgjatë vijës bregdetare. Sasia e madhe e mbetjeve të ngurta të cilat depozitohen në breg, të ndihmuar edhe nga era që i transporton në det, e ka bërë këtë zonë të mos përdoret për not apo peshkim.

1.2.4 Ndotja nga nafta dhe hidrokarburet e tjera në basenin e Ishmit

Në aeroportin e Rinasit ka një numër të konsiderueshëm të njësive të servisit të makinave dhe pikave të karburantit, të cilat janë burimi kryesor i ndotjes. Kjo është për shkak të derdhjes së vajrave në tokë, duke ndotur tokën dhe ujin sipërfaqësor. Si burim ndotjeje përbëjnë edhe mbetjet nga makinat e vjetëruara. Përsa i përket ndotjes së ujërave nëntokësore, burimet kryesore të ndotjes janë depozitat/tanket e naftës dhe rrjedhjet e lubrifikantëve dhe karburantet e makinerive të rënda gjatë procedurave të punës apo edhe rastet e derdhjeve aksidentale. Gjithashtu ndërrimi i vajit të makinerive pa marrë parasysh masat përkatëse, mund të bëhet shkak për ndotjen e ujërave nëntokësore. Zonat më të rrezikuara janë ato që ndodhen pranë puseve të ujit dhe në fakt këto zona janë të shumta përgjatë lumit Ishëm. Në rast të derdhjes së një sasive të konsiderueshme karburanti dhe vaji lubrifikues, hidrokarburet, për shkak të gravitetit do të lëvizin drejt thellësisë duke u bashkuar me ujërat nëntokësore. Ato gjithashtu do të përzihen me ujin sipërfaqësor, duke formuar emulsione. Derdhja e vajrave lubrifikues është bërë një faktor i rëndësishëm kërcënues për jetën ujore. Sipas të dhënave për vlerat INS (Indeksi i Ndotjes Sensitive) (Meço M, & Miho A. 2014) në periudhën 2012-2013 stacioni i Rinasit i përket një cilësie të keqe (vlera IPS 3.34).

1.2.5 Ndotja nga tokat dhe materialet inerte përgjatë bregdetit të Ishëm

Përgjatë brigjeve të lumit Ishëm ka edhe shumë materiale inerte të hedhura në lumë dhe bregun e tij. Në këtë mënyrë uji ndotet me mbetje që do të qëndrojnë në habitatet ujore për një kohë të gjatë. Këto mbetje ndikojnë si në cilësitë fiziko-kimike të ujit, por edhe në gjendjen e biodiversitetit.

Figura 3- Pamje e grykëderdhjeve të lumit Ishëm në detin Adriatik



Figura 4- Ndotja e ujit me mbetje të ngurta dhe inerte në stacionin e Rinasit (Dibër, H. 2015)



Figura 5- Gjendja e lumit Zezë në dy stacione të monitoruara (Dibër, H. 2015)



Figura 6- Pamje e lumit Ishëm në stacionin Ura e Telit dhe stacionin Salmer (Dibër, H.2014 & 2015)




1.3 GJENDJA E BASENIT TË LUMIT ISHËM

Bazuar në burimet metrologjike dhe informacionin e marrë nga artikujt online si dhe një studim të kryer nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave në lidhje me faktorët antropogjenë në basenin ujëmbledhës të Tiranës, ku janë studiuar tre lumenj, përkatësisht lumi Lana, Tirana dhe Ishëm, është bërë një analizë përse i përket karakteristikave fiziko-kimike, ku këto karakteristika janë analizuar në raport me njëra-tjetrën.

1.3.1 Temperatura

Sipas grafikut (Figura 7) vihet re se vlera më e lartë mesatare e temperaturës gjendet në lumin Ishëm (18,42 °C), ndërsa për lumenjtë Lana dhe Tirana vlerat mesatare të temperaturës janë më të ulëta (16,04°C). Vlera e lartë e temperaturës së lumit Ishëm është rezultat i shtrirjes gjeografike të lumit, faktit që lumi shkon më tej në drejtim të pjesës perëndimore të vendit (pranë detit Adriatik) ku domosdoshmërisht vihet re një rritje e lehtë e temperaturës si rezultat i kushteve gjeografike dhe meteorologjike.


Figura 7- Vlerat mesatare të temperaturës, sipas lumenjve.



1.3.2 pH

Në përgjithësi vërehet se vlerat mesatare të pH për tre lumenjtë janë në intervalin e vlerave të tyre neutrale. Vlerat mesatare të pH të këtyre lumenjve i klasifikojnë këta lumenj në klasën I, sipas NIVA (Figura 8).


Figura 8- Vlerat mesatare të pH të lumenjve.



1.3.3 Kripësia

Për sa i përket kripësisë, lumi Ishëm, krahasuar me lumenjtë e Lanës dhe të Tiranës, ka vlera më të larta (0.23 g/kg), lumi Lana vjen i dyti me një vlerë më të ulët prej 0.1 g/kg dhe vlera më e ulët matet në lumin e Tiranës. Vlera e lartë e kripësisë së lumit Ishëm, vjen si pasojë e daljes së lumit në detin Adriatik (në grykëderdhjen e tij, procesi i difuzionit) Figura 9.


Figura 9- Vlerat mesatare të kripësisë së lumenjve



1.3.4 Totali i lëndëve të ngurta pezull

Totali i lëndës së ngurtë pezull në ujë varion nga vlera më e ulët e gjetur në lumin Lana (58.22mg/l) deri në vlerën më të lartë të gjetur në lumin Ishëm (89.32 mg/l). Rritja e vlerave totale të ngurta pezull në lumin e Tiranës dhe lumit Ishëm, janë pasojë e erozionit të brigjeve të këtyre lumenjve. Duke marrë në konsideratë vlerat mesatare të TSS të tre lumenjve, sipas NIVA, këta lumenj klasifikohen në klasën V (Figura 10).


Figura 10- Vlerat mesatare të lëndës pezull të lumenjve



1.3.5 Oksigjeni i tretur

Lumi i Tiranës ka vlerën më të lartë të oksigjenit të tretur (6.14 mg/l), i dyti vjen lumi i Lanës (5.80 mg/l) dhe në fund lumi Ishëm me një vlerë mesatare 5.50 mg/l. Vlera e ulët e DO të lumit Ishëm mund të shpjegohet me rritjen e nivelit të ndotjes në të dy lumenjtë Lana dhe Tiranë, të cilët duke u bashkuar në Ishëm ulin ndjeshëm vlerat e oksigjenit të tretur. Figura 11). Klasifikimi i lumenjve Lana, Tirana dhe Ishëm, sipas NIVA dhe UNECE është i klasës III, pra me cilësi mesatare.


Figura 11- Vlerat mesatare të oksigjenit të tretur të lumenjve



1.3.6 NKO

Sipas grafikut në Figura 12) vlera mesatare më e lartë e NKO gjendet në lumin Lana (74.83 mg/l). Përsa i përket lumenjve Tiranë dhe Ishëm, ato variojnë përkatësisht në 32,33 mg/l dhe 42,17 mg/l.


Figura 12- Vlerat mesatare të NKO të lumenjve



1.3.7 NBO₅

Sa i përket NBO-së pas 5 ditësh, vihet re se vlerën më të lartë e ka lumi i Lanës (43.3mg/l), lumi i Tiranës ka një vlerë më të ulët (16.16mg/l) dhe lumi i Ishmit ka një vlerë më të ulët se Lana, por më e lartë se lumi i Tiranës (25.5 mg/l) (Figura 13). Sipas klasifikimit UNECE, këta lumenj klasifikohen në klasën V.

Figura 13- Vlerat mesatare të NBO₅ të lumenjve




1.3.8 Lëndët ushqyese - azoti dhe fosfori

1.3.8.1 NH₄⁺

Për nga vlerat e amonit, lumi i Lanës është lumi me vlerën mesatare më të lartë për të gjithë vitin (10.49mg/l), i ndjekur nga lumi Ishëm me 9.71mg/l dhe në fund lumi i Tiranës (5.67mg/l). Ky është një rezultat i pritshëm, me derdhjen në lumin Lanë të kolektorëve të shkarkimit të ujërave të ndotura të qytetit të Tiranës (Figura 14).

Figura 14- Vlerat mesatare të amonit të lumenjve




Për sa i përket klasifikimit të ujërave të lumenjve sipas NIVA, ky klasifikim është përkatësisht: lumenjtë Lana dhe Tirana i përkasin klasës IV, ndërsa lumi Ishmi klasifikohet në klasën V. Ndërkohë klasifikimi sipas UNECE është klasa V për lumenjtë Lana dhe Ishëm dhe klasi IV për lumin e Tiranës.

1.3.8.2 NO_2^-

Vlerat mesatare të nitriteve renditen sipas kësaj shkalle Lana - Tiranë - Ishmi, përkatësisht me 0.07mg/l - 0.04mg/l –0.02mg/l (Figura 15).


Figura 15- Vlerat mesatare të nitriteve të lumenjve



1.3.8.3 NO_3^-

Vlerat mesatare të nitrateve (Figura 16) kanë të njëjtin rend si nitritet, pra Lana me vlera mesatare vjetore më të larta 0,54 mg/l, më pas lumi i Tiranës me 0,38 mg/l dhe në fund lumi Ishëm me 0,25 mg/l. Të tre këta lumenj, për nga vlerat mesatare vjetore të nitrateve, sipas klasifikimit UNECE i përkasin klasës I.


Figura 16- Vlerat mesatare të nitrateve të lumenjve



1.3.8.4 P-PO₄³⁻

Lidhur me performancën e vlerave mesatare të fosfateve (Figura 17) në këta lumenj vlerën më të lartë e ka lumi i Lanës me 1,15 mg/l, i ndjekur nga lumi Ishëm me 0,91 mg/l dhe në fund lumi i Tiranës me 0,56 mg/l.


Figura 17- Vlerat mesatare të fosfatit të lumenjve



1.3.8.5 Fosfori Totali (P_{total})

Vlerat mesatare vjetore të fosforit total variojnë nga 1.13mg/l në lumin Lana, në 0.92mg/l në lumin Ishmi dhe në 0.44mg/l në lumin e Tiranës. (Figura 18).

Figura 18- Vlerat mesatare të fosforit total të lumenjve



Sipas NIVA, lumenjtë klasifikohen si më poshtë: lumenjtë Lana dhe Ishëm klasifikohen në klasën V, ndërsa lumi i Tiranës në klasën IV. Sipas UNECE, të gjithë lumenjtë klasifikohen si klasa V.

1.4 NDIKIMET

Deri në periudhën paraindustriale të shekullit të 19-të, ndotja e ujit ishte kryesisht një problem jo shqetësues, i shkaktuar nga ndotje të vogla, kryesisht nga shkarkimet e lëngjeve. Shumica e mbetjeve ishin me origjinë shtazore ose njerëzore, dhe nganjëherë nga përbërës të tjerë organikë ose inorganik nga industria (Stanners et Bourdeau, 1995). Në zonat me popullsi të rrallë, pa sisteme kanalizimesh, këto probleme ende kapërcehen lehtësisht nëpërmjet aftësisë vetëpastruese të lumenjve. Zhvillimi industrial dhe qytetërimi modern pas shek. XIX – XX çoi në formimin e zonave të mëdha të banuara, me industri dhe bujqësi të zhvilluar intensivisht. Kjo shkaktoi një rritje të shkarkimeve të ujit pa asnjë trajtim paraprak, përtej mundësisë së ujit të vetëpastruar. Për këtë arsye, në ditët e sotme shëndeti dhe zhvillimi i njeriut po ndikon gjithnjë e më shumë në cilësinë dhe sasinë e ujit.

Sipas materialit *Ndikimi mjedisor i faktorëve antropogjenë në basenin e lumit Ishëm* (Murgu H., Muça F., Hysa R. Raporti hidrologjik: Rimëkëmbja urbane e bllokut ndërmjet Bulevardit Blu dhe rrugës OSBE, Bashkia Kamëz):

Si përfundim mund të thuhet se parametrat më kritikë të cilësisë së basenit të lumit Ishëm janë:

- a) Përbërësi dominues i ndotësit në ujë është P-totalit, i cili përcakton se lumi Ishëm ka një ndikim të lartë fosfatesh me vlerë 0,135 meq/l, me rend $P_{total} > P-PO_4^{3-} > NO_2^- > NO_3^-$.
- b) Vlera shumë e lartë e totalit të lëndëve të ngurta pezull, si rezultat i erozionit të shpejtë në basen. Vlerat mesatare vjetore variojnë nga 54,1 mg/l në st-L2 në 107,9 mg/l në st-T3.
- c) Rritja e vlerave të kripësisë së ujit të lumit gjatë rrjedhjes në zonën urbane. Shkak i kësaj rritjeje në rrjedhën e poshtme të lumenjve është shkarkimi i mbetjeve të lëngshme urbane, ndërsa për stacionin e fundit Ish3 duhet theksuar se në rezultatet ndikon edhe procesi i difuzionit. Vlerat më të larta të kripës vërehen në periudha të thata.
- d) Vlerat e ulëta të oksigjenit të tretur në pjesën e poshtme të rrjedhës së lumit, për shkak të shkarkimit të mbetjeve urbane (ujërave të ndotura) të qytetit të Tiranës dhe bashkive përreth. Shkarkimet e mëdha të mbetjeve urbane në ujërat e tyre shkaktojnë deoksigenim të ujërave duke shkaktuar zhdukjen e jetës në to.
- e) Vlerat e larta të NKO-së në të gjitha stacionet e monitorimit, vlerat mesatare variojnë nga 14mg/l në st-T1 deri në 103mg/l në st-L2.
- f) Vlerat e larta të NBO₅ në të gjitha stacionet e monitorimit përveç st-L1 dhe st-T1. Vlera minimale u regjistrua në stacionet L1 dhe T1 në 2mg/l ndërsa vlera maksimale u regjistrua në L3 në 95 mg/l. Në raport me normat e BE-së, ujërat e lumenjve Ishëm, Tiranë dhe Lana duket se po kalojnë normat e lejuara për mbijetesën e peshkut. Shkaku kryesor i kësaj çështjeje është sasia e madhe e shkarkimeve të mbetjeve urbane në ujërat e këtyre lumenjve, gjë që shkaktonte deoksigenimin e ujërave, duke rritur kështu nevojën biologjike për oksigjen.

- g) Vlerat e larta të amonit në pothuajse të gjitha stacionet e baseneve, si rezultat i shkarkimeve të lëngjeve urbane. Përqendrimi mesatar i amonit për 36 matjet e marra gjatë këtij monitorimi është 8,622 mg/l, që është rreth trembëdhjetë herë më e lartë se vlera mesatare e raportuar për 580 stacionet lumore evropiane (0.66 mg/l).
- h) Përmbajtja e nitriteve është një tregues i ndotjes nga shkarkimet e ujërave të zeza. Nivele të larta u gjetën në ujin e lumit Lana (st-L2, mesatarisht 0,104 mg/l); Vlerat shumë më të ulëta rezultuan në stacionin st-T1 me një vlerë mesatare prej 0,006 mg/l. Sipas NIVA, vetëm stacioni st-T1 i plotëson kushtet për ujërat qiprinide.
- i) Vlerat e larta të nitrateve në stacionet që përshkojnë qytetin st-T2, st-T3 dhe st-L2, st-L3. Vlerat variojnë nga 0,075 mg/l st-T1 për E3 deri në 0,982 mg/l në st-L2 për E2. Vlerat e ulëta të nitrateve në stacionet e Ishëm mendohet se janë për shkak të aftësisë vetëpastruese të ujërave. Krahasuar me kufijtë e Direktivës së BE-së (CEE / CEEA / CE 78/659: BMZ, 1995;) uji i basenit të lumit Ishëm ka një përmbajtje nitratësh që i kalon shumë nivelet e rekomanduara.
- j) Për të gjitha stacionet përqendrimet e P-PO₄ janë më të larta se kufiri prej 0.2 mg/l i Direktivës së BE-së për ujërat salmonide dhe 0.4 mg/l për ujërat qiprinide. Vlerat shumë të ulëta të fosfatit janë matur në ujin e stacionit st-L1 0,14mg/l dhe st-T1 0,068 (që plotësojnë kërkesat për salmonidet dhe qiprinidet). Rritja e përqendrimit të fosfateve mbi vlerat e nevojshme të prodhimit të biomasës përbën një rrezik, duke nxitur lulëzimin e algave planktonike dhe shndërrimin e ujit në një gjendje eutrofike apo edhe distrofike. Burimet kryesore të fosfateve në ujin natyror janë detergjentët dhe plehrat fosfatike.
- k) Vlerat e larta totale duke i klasifikuar ujërat e basenit si cilësi shumë të dobët.

2. PRESIONET SIPAS TRUPAVE UJORË

TABELA E TRUPAVE UJOR (1-23)

Tabela 2– Ishëm (RW351411) Presionet e trupave ujore

Përshkrimi i kategorisë së presioneve		Trupi ujor Kodi 351411		Koordinatat e presionit		
		Presioni	Përshkrimi i presioneve	X	Y	Z
1.1	Pikësore- Ujërat e ndotura urbane	1.1				
1.2	Pikësore - Vërshimet ujore nga reshjet	1.2				
1.3	Pikësore - Impiantet sipas Direktivës së Emetimeve Industriale (DEI)	1.3				
1.4	Pikësore - Impiante jo DEI	1.4				
1.5	Pikësore - Vende të kontaminuara ose zona industriale të braktisura	1.5				
1.6	Pikësore - Vendet e depozitimit të mbetjeve	1.6				
1.7	Pikësore - Ujërat e minierës	1.7				
1.8	Pikësore -Akuakulturë	1.8				
1.9	Pikësore -Tjetër	1.9				
2.1	I shpërndarë –Vërshimet urbane	2.1				
2.2	I shpërndarë - Bujqësia	2.2				
2.3	I shpërndarë - Pylltaria	2.3				
2.4	I shpërndarë - Transporti	2.4				
2.5	I shpërndarë - Vende të kontaminuara ose zona industriale të braktisura	2.5				

2.6	I shpërndarë - Shkarkimet e palidhura me rrjetin e kanalizimeve	2.6		
2.7	I shpërndarë - Depozitimi atmosferik	2.7		
2.8	I shpërndarë - Minierat	2.8		
2.9	I shpërndarë - Akuakultura	2.9	1. Rrjetë peshkimi	1. 463166.161 1. 4604742.655
			2. Rrjeta e peshkimit	2. 463305.002 2. 4604711.103
			3. Rrjeta e peshkimit	3. 463166.16 3. 4604742.655
			4. Rrjeta e peshkimit	4. 463652.652 4. 4604740.183
			5. Rrjeta e peshkimit	5. 464184.243 5. 4604490.703
2.10	I shpërndarë - Tjetër	2.10		
3.1	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës – Bujqësi	3.1		
3.2	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Furnizimi publik me ujë	3.2		
3.3	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Industri	3.3		
3.4	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Ujë ftohës	3.4		
3.5	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Hidroenergja	3.5		
3.6	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Fermat e peshkut	3.6		
3.7	Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Të tjera	3.7		
4.1.1	Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut - Mbrojtje nga përmytjet	4.1.1		
4.1.2	Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut – Bujqësia	4.1.2		

4.1.3	Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut-Lundrimi	4.1.3
4.1.4	Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut-Të tjera	4.1.4
4.1.5	Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut-E panjohur	4.1.5
4.2.1	Diga, barriera dhe ndërprerje - Hidrocentrali	4.2.1
4.2.2	Diga, barriera dhe ndërprerje - Mbrojtje nga përmbytjet	4.2.2
4.2.3	Diga, barriera dhe ndërprerje - Uji i pijshëm	4.2.3
4.2.4	Diga, barriera dhe ndërprerje - Ujitje	4.2.4
4.2.5	Diga, barriera dhe ndërprerje - Rekreacion	4.2.5
4.2.6	Diga, barriera dhe ndërprerje - Industri	4.2.6
4.2.7	Diga, barriera dhe ndërprerje - Lundrimi	4.2.7
4.2.8	Diga, barriera dhe ndërprerje - Të tjera	4.2.8
4.2.9	Diga, barriera dhe ndërprerje - E panjohur	4.2.9
4.3.1	Ndryshimi hidrologjik - Bujqësi	4.3.1
4.3.2	Ndryshimi hidrologjik - Transport	4.3.2
4.3.3	Ndryshimi hidrologjik - Hidroenergja	4.3.3

4.3.4	Ndryshimi hidrologjik-Furnizimi me ujë publik	4.3.4
4.3.5	Ndryshimi hidrologjik - Akuakulturë	4.3.5
4.3.6	Ndryshimi hidrologjik-Të tjera	4.3.6
4.4	Ndryshim hidromorfologjik - Humbje fizike e të gjithë ose një pjese të trupit uhor	4.4
4.5	Ndryshim hidromorfologjik - Tjetër	4.5
5.1	Speciet dhe sëmudjet e ardhura	5.1
5.2	Shfrytëzimi ose largimi i bimëve shtazore	5.2
5.3	Hedhja e mbeturinave të lehta	5.3
6.1	Ujërat nëntokësore-Rimbushjet	6.1
6.2	Ujërat nëntokësore-Ndryshimi i nivelit ose vëllimit të ujit	6.2
7	Presioni antropogjen-Tjetër	7
8	Presioni antropogjen - i panjohur	8
9	Presioni antropogjen-Ndotja historike	9